

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË TATIMEVE KUKËS

Në bazë të programit të auditimit “Mbi zbatimin e legjislacionit tatimor në procesin e realizimit të të ardhurave tatimore, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore si dhe vlerësimi dhe funksionimi i kontrollit tatimor në DRT, Kukës” për periudhën 30.09.2013 deri në 30.09.2015 me numër nr. 830/1, datë 19.09.2015, me ndryshime Kontrolli i lartë i Shtetit ushtroi auditimin e përputhshmërisë dhe rekomandoi masat për përmirësimin e gjendjes, miratuar nga Kryetari me Vendimin nr. 181 datë 30.12.2013.

Bazuar në nenet 15, 25 dhe 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", me shkresat nr 830/13 datë 31.12.2015, është dërguar në DRT Kukës dhe nr. 830/14, datë 31.12.2015, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet.

Kontroli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Për vitin 2013 dhe 2014 DRT Kukës paraqitet me mos realizim të të ardhurave, përkatësisht 95% dhe 98%. Të njëjtën performancë vihet re dhe në realizimin e treguesve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore. Në vitin 2015 deri në Shtator, ndonëse në kushte të një reduktimi të personelit dhe detyrave funksionale në drejtim të sektorit të kontrollit operacional dhe sektorit të vlersimit të të ardhurave plani paraqitet me realizim në masën 109%, ku disa tregues paraqiten me mbi 200% dhe disa të tjerë me nën realizim.

Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet 11-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës të analizojë këtë situatë duke ripërcaktuar planin e të ardhurave për vitin 2015 si në nivel ashtu dhe në strukturë, si dhe duke përcaktuar zonat e riskut në fushën e detyrave funksionale dhe angazhimin e personelit.

Afati: brenda tremujorit të parë të vitit 2016

2. Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit në dosjet e tatimpaguesit për dinamikën, lëvizjen dhe dokumentacionin e domosdoshëm për ç`regjistrim të tatimpaguesit u konstatua se janë lëshuar vërtetime për tatimpaguesit në ndryshim nga formati i miratuar nga DPT.

Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet 18-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit rekomandojmë:

Drejtoria e Shërbimit për Tatimpaguesin, në DRT Kukës të kërkojë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për miratimin e formateve shtesë të vërtetimeve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tatimpaguesit.

Afati: Menjëherë

3. Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit lidhur procedurat e ndjekura për planifikimin për kontroll nga DPMA u konstatua se niveli i mbulimit me kontroll paraqitet në nivele të ulta për subjektet problematikë. Kështu, nuk janë planifikuar dhe kontrolluar subjektet me gjendje më të lartë kreditore, me parregullsi në deklaram, me nivele të larta të detyrimeve të pashlyera, në kundërshtim me Udhëzimin e DPT-së nr. 4219 datë 27.02.2013.

Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet 40-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit rekomandojmë:

DPMA, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, si dhe Drejtoria e Mbledhjes së Borxhit, në DRT Kukës të rrisin bashkëpunimin dhe të dalin me një propozim të përbashkët për subjektet tatimpagues që do ti nënshtrohen kontrollit tatimor.

Afati: Në vijim

4. Nga auditimi u konstatua se nga DPMA nuk janë hedhur në sistem detyrimet e evidentuara nga Drejtoria e Kontrollit në DRT Kukës në shumën **50,320,667 lekë**, për 42 subjekte, e pasqyruar në aneksin 3.1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet 29-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit rekomandojmë:

a. Nga DPMA në DRT Kukës të iniciohen programe me tematikë pasqyrimin në sistem C@ST të të gjithë detyrimeve të subjekteve të pasqyruara në aneksin 3.1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit..

b. Të evidentohen të gjithë interesat e gjeneruar në bazë të nenit 115 në ligjit nr 9920 dt 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” si pasojë e vonesës dhe për këto shuma të ngarkohen personat përgjegjës, të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit..

Afati: Menjëherë

5. Nga auditimi i treguesive të realizimit të të ardhurave nga kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore u konstatua se niveli i derdhur i sigurimeve për një punonjës në sektorin privat është disa herë më i vogël se sa ai në sektorin shtetëror, duke qenë në nivele poshtë pagës minimale në shkallë vendi.

Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet 37-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit rekomandojmë:

Nga DPMA, në DRT Kukës, të evidentohen subjektet private me numër minimal punonjësish, dhe nën pagën minimale dhe të propozohen për kontroll tematik.

Afati: brenda gjashtëmuajorit të parë 2016

6. Në akt konstatimet e mbajtura nga inspektorët e kontrollit në terren, me objekt “*Pajisjen e subjekteve me kasa fiskale dhe lëshimin e kuponit tatimor*”, u konstatua se në përgjithësi nga ana e inspektorëve nuk është përshkruar në akt konstatimi numri i

fiskalizimit të kasës apo numri serial i kasës, apo nuk është bashkangjitur (fotokopje), kupon tatimor në datën e kryerjes së kontrollit.

Po kështu në rastet e konstatimit të subjekteve në fazën e regjistrimit, në shumicën e rasteve nuk është bashkangjitur formulari i aplikimit në QKR. Nga ana e inspektorëve nuk është lënë gjurmë mbi kontrollin e kryer.

Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet 79-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit rekomandojmë:

Të merren masa për përpilimin e formateve tip të akt verifikimeve, ku të specifikohen me pika të veçanta problematika e tematikës për kontroll, për të pajisur inspektorët e verifikimit në terren.

Afati: Në vijim

7. Në Drejtorinë Rajonale Tatimore Kukës për periudhën objekt auditimi u konstatua se ka mungesa të theksuara në organikë kështu: nga 23 punonjës në organikë për vitet 2013 dhe 2014, aktualisht ka patur 13 punonjës. Gjatë zbatimit të detyrave funksionale dhe detyrave të urdhëruara nga DPT stafi është qarkulluar në disa pozicione duke e shoqëruar me mbivendosje detyrash gjë që ka sjellë rendiment të ulët në punë dhe ulje rezultati në mbledhjen e detyrimeve tatimore. Për mbarëvajtjen e punës janë kryer lëvizje paralele brenda organikës duke shtuar numrin punonjësve në Sektorin e Terrenit me 5 punonjës nga të cilët 3 nga Sektori i Kontrollit Operacional dhe 1 nga Sektori i Vlerësimit dhe një nga Sektori i IT, duke dobësuar punën në këta sektorë.

Për sa më sipër, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Nisur nga risku operacional i shfaqur, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante për tu normalizuar aktiviteti në këtë Drejtori.

Afati: Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

I. Nga DRT Kukës të merren masa të menjëhershme për vjeljen e detyrimeve të lindura në shumën **68.556.232 lekë**, nga subjektet tatimpagues, të cilët rezultojnë me detyrime tatimore të pa përlllogaritura nga administratat tatimore.

1. Të merren masa për shlyerjen e detyrimeve nga 61 subjekte për vitin 2013 dhe 83 subjekte për vitin 2014, për 271 raste të mos vendosjes së penalteteve **në shumën 2,710,000 lekë**, sipas aneksit nr. 3.2 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga inspektorët e DPMA, në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.20068, neni 126 "Mosdhënia e informacionit". (Trajtuar në faqet 40-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Afati: Menjëherë

2. Të merren masa për rikontrollin, evidentimin dhe përpilimin e njoftim vlerësimeve të detyrimeve të 17 subjekteve, sipas tematikës të trajtuar në këtë raport auditimi, sipas aneksit nr. 4.2, për mos vendosjen e penaliteteve **në shumën 62.546.232 lekë**, nga inspektorët e Drejtorisë së Kontrollit, shkelje në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” dhe Manualin e Kontrollit. *(Trajtuar në faqet 47-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Afati: Menjëherë

3. Të merren masa për rikontrollin, evidentimin dhe përpilimin e njoftim vlerësimeve të detyrimeve të subjekteve, sipas tematikës të trajtuar në këtë raport auditimi, për reduktimin e penaliteteve **në shumën 1,033,170 lekë**, nga inspektorët e Drejtorisë së Kontrollit, shkelje në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” dhe Manualin e Kontrollit. *(Trajtuar në faqet 75-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Afati: Menjëherë

4. Të merren masa të menjëhershme për rikontrollin, evidentimin dhe përpilimin e njoftim vlerësimeve të detyrimeve për 50 subjekte, sipas aneksit nr. 4.3, për mos vendosjen e penaliteteve **në shumën 3,300,000 lekë**, nga inspektorët e kontrollit në terren, në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” dhe Manualin e Kontrollit. *(Trajtuar në faqet 79-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Afati: Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, *i rekomandojmë* Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Kukës, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme, sipas pikës 1 të nenit 57 dhe nenit 58 të ligjit nr. 152/2013, të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe dhënien e masës, sipas nenit 59.2 për **5 nëpunës**:

I. Neni 58 gërma “ç”, “mos ngritje në detyrë për një periudhë deri në gjashtë muaj” për 4 nëpunës, si më poshtë:

2 inspektorë në Drejtorinë e Kontrollit dhe

2 inspektorë në Sektorin e Verifikimit në Terren.

Për veprime jo në përputhje me ligjin 9920 dt 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, ligjit 7928 dt 27.04.1995 “Për TVSH-në”, ligjit 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, Rregullores së Brendshme të DPT-së si dhe Manualit të

Kontrollit që ka sjellë për pasojë efekt financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit.

II. Neni 58 gërma “b”, “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” për 1 nëpunës:

1 inspektor në DPMA

Për veprime jo në përputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, ligjit 7928 dt 27.04.1995 “Për TVSH-në”, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, Rregullores së Brendshme të DPT-së si dhe Manualit të Kontrollit që ka sjellë penalizim përtej parashikimeve ligjore.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 181 datë 30.12.2013, është ngarkuar Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Shënim: Auditimi u krye përgjatë periudhës 03.06.2015 deri më 27.07.2015, nga audituesit shtetëror: Edvin Stefani, Vladimir Rizvani dhe Dorino Meçe. Auditimi u mbikëqyr nga Drejtori i Departamentit zj. Albana Agolli, u shqyrtua nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, z. Ermal Yzeiraj dhe Drejtori i Përgjithshëm zj. Manjola Naço.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

Nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Kukës akoma nuk është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor prej 20 ditësh.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT